



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika d), dhe nenit 15 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 dt. 2008"), nenit 11 e 12. të Ligjit Nr.03/L -145 Për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 60 dt. 05. Nëntor 2009"),nenit 5. të Rregullores Nr. 01/2013 për Hartimin dhe Publikimin e Akteve të Komunave të MAPL. Nr. 0203 – 76, të dt. 24.01.2013, dhe Nenit 8, paragrafi 1, e nenit 9, paragrafi 1, pika d) të Statutit të Komunës së Pejës, 01.Numër:09 – 8103 datë: 29.shtator 2008, Kuvendi Komunal Pejë, pas procedurës së diskutimit publik, në mbledhjen e mbajtur më date: 30 janar 2015, miraton:

RREGULLORE KOMUNALE Nr. 03/2015 **Për Kompleksin Rinor "Peja"**

Neni 1 – Qëllimi

- a. Rregullorja për Menaxhimin e Kompleksit Rinor - Peja (këtu e tutje "Rregullorja") ka për qëllim përcaktimin dhe definimin e pronësisë, menaxhmentit, organizimit të brendshëm, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe aktiviteteve që zhvillohen në Kompleksin Rinor-Peja (këtu e tutje KRP).

Neni 2 – Përkufizimet

Shkurtesat që përdoren në këtë rregullore kanë kuptimin e vetë të cilat shpjegohen në vijim:

- a. **DKRS** – Nënkupton Drejtorati për Kulturë Rini dhe Sport që është pjesë e ekzekutivit të komunës së Pejës dhe është kompetent për organizimin jetes Kulturore, Rinore dhe Sportive në komunën e Pejës.
- b. **KRP** – Nënkupton objektin e Kompleksit Rinor-Peja ku përfshihet objekti dhe fusha e sportit.
- c. **KVRL** – Nënkupton Këshillin e Veprimit Rinor që është organ i përcaktuar me ligj për organizimin e rinisë në nivel lokal dhe për promovimin e aktiviteteve rinore në komunë.
- d. **OJQ** – Nënkupton Organizata Jo Qeveritare të cilat veprojnë në nivel komunal.
- e. **Menaxheri i KRP** – është zyrtar i komunës respektivisht Drejtoratit për Kulturë Rini dhe Sport i cili përkujdeset për objektin e qendres rinore dhe për koordinimin e organizatave dhe individëve që frekuentojnë në këtë objekt.

Neni 3 - Emri dhe Simbolet

- a. Objekti i rregulluar me këtë rregullore quhet: Kompleksi Rinor “Peja” me shkurtesen KRP.

Neni 4 - Fushëveprimi i rregullores

- a. Kjo rregullore është e vlefshme vetëm për objektet e Kompleksit Rinor, për strukturat administrative të saj dhe për aktivitetet që zhvillohen në të.

Neni 5 - Objekti i Kompleksit Rinor-Peja

- a. Objekti i KRP është pronë publike e komunës së Pejës dhe komuna e Pejës është organi i vetëm kompetent që vendos për të.
- b. Objekti i KRP ndodhet në adresën rr: Nuredin Basha pn . Është ndërtesë dy katëshe.
- c. Objekti ka gjithësejt 5 hapsira të ndara të cilat shërbejnë si zyre pune, ka dy salla që shërbejnë për aktivitete sportive dhe kulturore, ka një sallë që shërben për takime dhe argëtim.
- d. Pjesë e KRP-së është edhe fusha e sportit e rrethuar me tribunë për shikues.

Neni 6 - Struktura Organizative

- a. KRP është nën administrim të Drejtoratit për Kulturë Rini dhe Sport dhe është pjesë strukturore e sektorit të rinisë.
- b. Struktura organizative e KRP-së janë: Këshilli Drejtues dhe Anëtarësia.
- c. Në Këshillin Drejtues të KRP-së bëjnë pjesë: Menaxheri i KRP-së, Kryetari i KVRL-së, Përfaqësuesit e OJQ-ve të vendosura në KRP sipas marrëveshjes në nenin 7 të kësaj rregulloreje.
- d. Këshilli Drejtues kryesohet nga Menaxheri i KRP-së.
- e. Vendimmarrja për aktivitetet që zhvillohen në KRP rregullohet me rregullore të brendshme dhe me marrëveshje me DKRS.

Neni 7 – Anëtarësia

- a. Anëtarë të KRP-së janë individët, organizatat jo qeveritare, grupet formale dhe jo formale rinore, grupet rinore shkollore, organizatat dhe grupet studentore.
- b. Cdo anëtarë, juridik apo fizik konsiderohet anëtarë vetëm kur ka nënshkruar marrëveshjen e mirëkuptimit të përgaditur nga KRP.

Neni 8 - Shfrytëzimi i Objektivit

- a. Të drejten e shfrytëzimit të Kompleksit Rinor e kanë anëtarët e saj dhe të gjithë individët pa dallim gjinie, moshe, etnie, feje, race, orientimi seksual.
- b. KRP-në kanë të drejtë ta shfrytëzojnë Organizata Jo Qeveritare (OJQ) që kanë karakter edukativ e që nuk bien ndesh me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës.
- c. KRP-në nuk kanë të drejtë ta shfrytëzojnë partitë politike, organizatat që nxisin urrejtje dhe prozeletizëm fetar.
- d. Shfrytëzimi i hapsirave dhe dhënia me qira e hapsirave të KRP-së nga OJQ apo palë të treta bëhet konform akteve normative në fuqi të Republikës së Kosovës respektivisht Komunës së Pejës.

Neni 9 - Aktivitetet që zhvillohen në KRP

- a. Në KRP mund të zhvillohen aktivitete të cilat kanë karakter edukativ, promovues, argëtues, sportive, kulturore.
- b. Në KRP nuk mund të zhvillohen aktivitete që bien ndesh me ligjin dhe rregulloret që mbrojnë të rinjtë nga fenomenet negative.

Neni 10 - Rregullimi dhe ndryshimi i hapsirave të KRP

- a. Investimet në KRP bëhen vetëm me miratimin dhe vendimin e kryetarit të komunës duke u bazuar në rekomandimin e Drejtorit të DKRS-së.
- b. Ndryshimet e vogla të hapsirave në KRP të cilat nuk dëmtojnë objektin, imazhin apo pasuritë e saj bëhen me pëlqimin e drejtorit të DKRS-së.

Neni 11 - Mirëmbajtja e KRP

- a. Komuna e Pejës nëpërmjet Drejtoratit për Kulturë Rini dhe Sport kujdeset për investimet, mirëmbajtjen fizike dhe për pastërtin e objektivit.
- b. KVRL dhe organizatat që e shfrytëzojnë këtë objekt për aktivitetet e tyre janë përgjegjës për mirëmbajtje të rendit dhe rregullit sipas Rendit Shtëpiak.
- c. Koordinator i KRP-së ngarkon me përgjegjësi të gjithë shfrytëzuesit e KRP-së me anë të një marrëveshje të mirëkuptimit.

Neni 12 – Financat

- a. KRP inkason të hyra nga dhënia me qira të hapsirave të veta për palët e interesuara dhe nga anëtarësia.
- b. Inkasimi i mjeteve bëhet sipas rregullores për taksa dhe tarifa e komunës së Pejës.
- c. Mjetet e inkasuara arkëtohen në zyrën e financave pranë DKRS-së.
- d. Mjetet e inkasuara menaxhohen nga DKRS me vendim të kryetarit të komunës së Pejës.

Neni 13 - Transparenca dhe Llogaridhënia

- a. Nën përkujdesjen e KVRL-së organizohen takime të rregullta pune me anëtarësinë.
- b. Menaxheri i KRP-së mban komunikim ditor me sektorin e rinisë respektivisht DKRS-në dhe raporton për punën dhe për rrjedhat financiare.
- c. KVRL mban të informuar të gjitha organizatat rinore për programet dhe aktivitetet e planifikuara të zhvillohen dhe që janë zhvilluar në KRP.
- d. OJQ e vendosura në KRP menaxhojnë vetë marrdhëniet me partnerët dhe anëtarët e tyre.

Neni 14 - Dispozitat kalimtare

- a. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb – faqen e Komunës.

01.Numer: 400 - 78727

Pejë, datë: 30 Janar 2015

KUVENDI KOMUNAL PEJË



**KRYESUESI,
Dr. Islam Husaj**